



**Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi  
strategjitë e integruara kombëtare për  
mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna**



# Strategjia e integruar kundër dhunës



## Hyrje

Në vitin 2005, Samiti i Varshavës i Krerëve të Shteteve dhe Qeverive i kërkoi Këshillit të Evropës:

- të nxisë efektivisht të drejtat e fëmijëve dhe të përmbushë plotësisht detyrimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve;
- të përfshijë të drejtat e fëmijëve në të gjitha politikat evropiane dhe të koordinojë aktivitetet e Këshillit të Evropës të lidhura me fëmijët; dhe
- të zhdukë të gjitha format e dhunës kundër fëmijëve, në veçanti nëpërmjet nisjes së një plani trevjeçar veprimi dhe masave specifike kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Fillimi i programit “Të ndërtojmë Evropën për fëmijët dhe me fëmijët” në vitin 2006 ishte përgjigje e këtij mandati, i cili u përcaktua më tej në strategjinë për vitin 2009-2011, të miratuar në Stokholm. Objektivi kryesor i programit është ofrimi i ndihmës për vendimmarrësit dhe aktorët që të krijojnë dhe zbatojnë strategji dhe politika kombëtare gjithëpërfshirëse për të nxitur të drejtat e fëmijëve dhe për të zhdukur të gjitha format e dhunës kundër fëmijëve, në kuadrin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe Studimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Dhunën kundër Fëmijëve.

Këshilli i Evropës filloi rishikimin e mënyrës sesi politikat, legjislacionet dhe praktikat kombëtare trajtojnë çështjen e dhunës në shtetet e saj anëtare për të formuluar rekomandimet në nivelin evropian. Metodologjia e përdorur përfshiu analiza të thelluara për shkallën dhe natyrën e dhunës kundër fëmijëve, kuadret ligjore dhe institucionale të krijuara për të luftuar këtë fenomen, tendencat e fundit në politikëbërje, strategji parandaluese kombëtare dhe lokale dhe zbatimin e tyre. Për rishikimet e politikave të para kombëtare dolën vullnetarë katër vende - Italia, Norvegjia, Portugalia dhe Rumania.

Konsultimet e gjera dhe ndërakteve në çdo shtet pilot çuan në prodhimin e katër raporteve kombëtare që përmbanin propozime për një strategji model kundër dhunës dhe sugjerime për përfshirjen e shembujve të praktikave të mira kombëtare, rajonale dhe vendore. Në bazë të përfundimeve dhe rekomandimeve të raporteve të përfshira në Studimin e Kombeve të Bashkuara për Dhunën kundër Fëmijëve, si dhe duke pasur parasysh punën e Këshillit të Evropës përpara i përket të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, si dhe Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi Strategjitë e Integruara Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna në veçanti u propozua një kuadër kombëtar shumë-disiplinor dhe sistematik për të parandaluar dhe për t’ju përgjigjur të gjitha rasteve të dhunës kundër fëmijëve. Udhëzimet pritet të nxisin edhe një ndryshim kulturor shumë të nevojshëm në perceptimin e fëmijëve si aktorë ndryshimi dhe të fëmijërisë si një faktor i rëndësishëm për shoqërinë në tërësi.




## Strategjia e integruar kundër dhunës



*Megjithëse fillimisht të synuar për vendimmarrësit në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal, udhëzimet i drejtohen dhe profesionistëve që punojnë për fëmijët dhe me fëmijët, shoqërisë civile, komunitetit, medias, dhe me vetë fëmijëve.*

*Udhëzimet janë zhvilluar nga një Grup Editorial i drejtuar nga Znj. Marta Santos Pais dhe i përbërë nga përfaqësues të katër shteteve pilote, ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfaqësuesve të UNICEF-it, OHCHR-ja, Komisionit Evropian, Avokatit të Popullit për Fëmijët, dhe përfaqësues të OJQ-ve. Gjatë procesit të draftimit, udhëzimet u janë bërë me dije partnerëve të ndryshëm, së pari me rastin e një konference të një niveli të lartë në Stokholm, Suedi (8-10 shtator 2008), dhe së fundmi në Platformën e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg (1-2 qershor 2009) duke siguruar një proces të gjerë konsultimi me aktorët kryesorë, duke përfshirë dhe komitetet dhe organet përkatëse drejtuese të Këshillit të Evropës.*

*Në nëntor të vitit 2009, Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës (që përfaqëson 47 shtete e tij anëtare) miratoi një rekomandim që përfshinte dhe udhëzimet. Këshilli i Evropës dëshiron që ky tekst dhe procesi që çon në miratimin e tij të frymëzojnë zhvillimin e strategjive kombëtare në Evropë dhe jashtë rajonit evropian.*





## Rekomandimi CM/Rek(2009)10

*Këshilli i Ministrave, sipas dispozitës së Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës;*

*Duke iu referuar Samitin e Tretë të Krerëve të Shteteve dhe të Qeverive (Varshavë, 16-17 maj 2005) si dhe angazhimeve të marra mbi bazën e tij për të marrë masa specifike për heqjen e të gjitha formave të dhunës kundër fëmijëve;*

*Duke iu referuar “Strategjisë 2009-2011 - Të Ndërtojmë një Evropë për Fëmijët dhe me Fëmijët”, e cila i jep Këshillit të Evropës rolin e iniciatorit rajonal dhe koordinuesit të iniciativave kombëtare dhe rajonale për të luftuar dhunën kundër fëmijëve dhe rolin e strukturës evropiane për ndjekjen e rekomandimeve të përfshira në Studimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Dhunën kundër Fëmijëve;*

*Duke iu referuar fushatës mbarë evropiane për rritjen e ndërgjegjësimit kundër ndëshkimit trupor të fëmijëve “Ngrini duart kundër rrahjes”, e nisur nga Këshilli i Evropës më 15 qershor 2008 në Zagreb, Kroaci;*

*Duke pasur parasysh që mirëqenia dhe interesi më i mirë i fëmijëve janë vlera thelbësore e të konsideruara si të tilla nga të gjithë shtetet anëtare dhe duhen nxitur pa asnjë diskriminim;*

*Duke njohur se dhuna kundër fëmijëve përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve, komprometon zhvillimin e fëmijëve dhe cenon gëzimin e të drejtave të tyre bazë;*

*Duke vënë re se dhuna kundër fëmijëve ekziston në të gjitha shtetet dhe i kalon kufijtë e seksit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo mendimeve të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, lidhjes me një pakicë kombëtare, pronës, lindjes, orientimit seksual, gjendjes shëndetësore, paaftësisë apo ndonjë statusi tjetër;*

*Duke pasur parasysh se brishtësia, vulnerabiliteti i fëmijëve dhe varësia e tyre tek të rriturit për rritjen dhe zhvillimin kërkojnë një investim më të madh në parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijëve nga familjet, shoqëria dhe shteti;*

*Duke pasur parasysh Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ETS nr 5), që u siguron të gjithëve brenda juridiksionit të shteteve anëtare, duke përfshirë dhe fëmijët, të drejtën për t’u mbrojtur nga tortura dhe trajtimin çnjerëzor ose degradues, të drejtën e lirisë dhe sigurisë, dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor;*

*Duke pasur parasysh Kartën e rishikuar Sociale Evropiane (ETS nr 163), në veçanti dispozitat e saj për të drejtën e fëmijëve për t’u mbrojtur nga neglizhenca, dhuna dhe shfrytëzimi;*

*Duke pasur parasysh Konventën Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve (ETS nr 160), Konventën për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (CETS nr. 197), Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual (CETS nr. 201) dhe instrumente të tjera përkatëse ligjore të Këshillit të Evropës;*



## Strategjia e integruar kundër dhunës



Duke marrë parasysh rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare: Rekomandimin CM/Rec(2009)5 për masat për mbrojtjen e fëmijëve kundër përmbajtjes dhe sjelljes së dëmshme dhe nxitjes së pjesëmarrjes së tyre aktive në një mjedis të ri informativ dhe komunikimi, Rekomandimin CM/Rec(2008)11 për Rregulloren Evropiane për autorët e krimeve me moshë të vogël që janë objekt sanksionesh dhe masash, Rekomandimin Rec(2006)19 për politikën për mbështetje të rritjes pozitive të fëmijëve nga prindërit, Rekomandimi (2006)12 për fuqizimin e fëmijëve për mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit; Rekomandimi Rec(2006)5 për Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës për nxitjen e të drejtave dhe të pjesëmarrjen e plotë të njerëzve me paaftësi në shoqëri: të përmirësojmë cilësinë e jetës së njerëzve me aftësi të kufizuara në Evropë 2006-2015, Rekomandimin Rec(2005)5 për të drejtën e fëmijëve që jetojnë në institucione kujdesi, Rekomandimin Rec(2001)16 për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual;


Duke pasur parasysh rekomandimet e mëposhtme të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës: Rekomandimin 1854 (2009) për aksesin e njerëzve me aftësi të kufizuara në të drejtat e tyre dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe aktive në shoqëri, Rekomandimin 1828 (2008) për zhdukjen e adoptimit të paligjshëm të sapolindurve në Evropë, Rekomandimin 1815 (2007) për prostitucionin - çfarë qëndrimi të mbajmë?, Rekomandimin 1778 (2007) për fëmijët viktime: heqjen e të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit dhe abuzimit, dhe Rekomandimin 1666 (2004) për një ndalim mbarë evropian të ndëshkimit trupor të fëmijëve;

Gjithashtu, duke marrë parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, në veçanti Nenin 19 të saj, duke parashikuar detyrimin e qartë që shtetet t'i mbrojnë fëmijët nga të gjitha format e dhunës në të gjitha kohët dhe rrethanat;

Duke u bazuar dhe në instrumente dhe angazhime të tjera përkatëse në këtë fushë, duke përfshirë Deklaratën e Rio de Zheneiros dhe Thirrjen për Veprim për të Parandaluar dhe Ndaluar Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve dhe Adoleshentë (2008);

Duke marrë parasysh rekomandimet e Studimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi Dhunën kundër Fëmijëve, në veçanti për të zhvilluar një kuadër të shumëfishtë dhe sistematik për t'ju përgjigjur dhunës kundër fëmijëve, të integruar në procesin kombëtar të planifikimit nëpërmjet një strategjie, politike ose plani kombëtar, dhe për identifikimin e një pike kontakti, mundësisht në nivel ministror, për mbikëqyrjen e zbatimit të masave për parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës;

I angazhuar për nxitjen e strategjive të integruara kombëtare, qëllimi i të cilave është ruajtja e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e tyre nga të gjitha format e dhunës, të ngulitura në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e fëmijëve, standardet e Këshillit të Evropës dhe e zhvilluar me pjesëmarrjen e fëmijëve,






## Strategjia e integruar kundër dhunës



*U rekomandon qeverive të shteteve anëtare, duke respektuar detyrimet e tyre ndërkombëtare dhe duke pasur parasysh strukturat e tyre specifike kombëtare, rajonale dhe lokale dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse:*

- a. të integrojnë, sipas nevojës, në legjislacionin, politikat dhe praktikën e tyre parimet, dhe të zbatojnë, sipas nevojës, veprimet e parashikuara në Udhëzimet e Këshillit të Evropës për Strategjitë e Integruara Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, siç jepen në Shtojcën I të këtij Rekomandimi;*
- b. të nxisin zbatimin dhe përdorimin e Udhëzimeve në fusha të cilat nuk janë përgjegjësi e drejtpërdrejtë ose kompetencë e organeve publike, por kur pavarësisht nga kjo gjë, ato kanë kompetenca ose mund të luanë një rol të caktuar;*
- c. të sigurojnë shpërndarjen më të gjerë të mundshme të këtij rekomandimi nëpërmjet fushatave të rritjes së ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, institucionet e pavarura për të drejtat e fëmijëve, median, sektorin privat, fëmijët dhe familjet;*
- d. të bashkëpunojnë me Këshillin e Evropës për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare nëpërmjet pikave të tyre të kontaktit për të drejtat e fëmijëve dhe eliminimin e dhunës kundër fëmijëve*
- e. të bashkëpunojnë për çështjet e dhunës kundër fëmijëve me mbështetjen e Përfaqësuesit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.*





## SHTOJCAT

### Përmbajtja<sup>1</sup>

Shtojca I - Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna .....	9
1. Përmbledhje ekzekutive .....	9
2. Qëllimet, fushëveprimi, përkufizimet dhe parimet .....	10
2.1. Qëllimet	
2.2. Fushëveprimi dhe përkufizimet	
2.3. Parimet	
3. Aksioni i integruar kombëtar, rajonal dhe lokal .....	13
3.1. Strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna	
3.2. Aksioni rajonal dhe lokal	
4. Ndërtimi i një kulturë për respektimin e të drejtave të fëmijës .....	15
4.1. Arsimi dhe rritja e ndërgjegjësimit	
4.2. Trajnimi profesional	
4.3. Mediat dhe shoqëria e informacionit	
5. Kuadrot e ndryshme .....	19
5.1. Kuadri ligjor	
5.2. Kuadri i politikave	
5.3. Kuadri institucional	
6. Shërbimet dhe mekanizmat miqësorë në funksion të fëmijës .....	26
6.1. Parime të përgjithshme	
6.2. Standardet e kujdesit për fëmijën	
6.3. Monitorimi i pavarur	
6.4. Raportimi i dhunës	
6.5. Mekanizmat referues	
6.6. Shërimi, rehabilitimi dhe ri-integrimin shoqëror	
6.7. Sistemi i drejtësisë	
7. Hulumtime dhe mbledhje të dhënash.....	31
8. Bashkëpunimi ndërkombëtar .....	33


1. Të gjitha tekstet e cituara nga Komiteti i Ministrave dhe nga Asambleja Parlamentare janë nga Këshilli i Evropës.



# Strategjia e integruar kundër dhunës



Shtojca II - Fjalorthi i termave .....	34
Shtojca III - Tekste ndërkombëtare që kanë për qëllim ruajtjen e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.....	38
Shtojca IV - Aksione dhe publikime të tjera .....	46







# Strategjia e integruar kundër dhunës



## Shtojca 1 e Rekomandimit CM / Rec (2009) 10

### *Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna*

#### 1. Përmbledhje ekzekutive

BNë përputhje me rekomandimet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Studimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi dhunën ndaj fëmijëve, këto udhëzime promovojnë zhvillimin dhe zbatimin e një kuadri tërësor kombëtar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për të çrrënjësuar dhunën ndaj fëmijëve.

Udhëzimet i referohen përkufizimeve të fjalëve "fëmijë" dhe "dhunë" sikurse përmbahen përkatësisht në nenet 1 dhe 19 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (të referuara më poshtë si KKPDF).

Udhëzimet janë të bazuara në tetë parimet e përgjithshme (mbrojtja nga dhuna, e drejta për jetën dhe mbijetesë maksimale dhe zhvillim, mos-diskriminimi, barazia gjinore, pjesëmarrja e fëmijëve, obligimet e shtetit, përgjegjësitë dhe pjesëmarrja e aktorëve të tjerë, veprime në interesin më të mirë të fëmijës) dhe katër parimet operative (natyra multidimensionale e dhunës, qasja e integruar, bashkëpunimi ndër-sektorial, qasja shumë aktorëve). Këto parime janë integruar në të gjithë dokumentin, duke përfshirë seksionet mbi veprimin e integruar kombëtar, rajonal dhe lokal; edukimin dhe masat për rritjen e ndërgjegjësimit; kuadrot ligjore, ato të politikave dhe ato institucionale; hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave.

Udhëzimet mbështesin promovimin e një kulture për respektimin e të drejtave të fëmijës, të bazuar në njohuri të thella për të drejtat e fëmijës dhe të kuptuarit e dobësive dhe aftësive të fëmijëve. Grupi përfitues kryesor përfshin të gjithë profesionistët që kanë të bëjnë dhe janë në kontakt me fëmijët.

Rekomandimet kryesore të udhëzimeve bëjnë thirrje për zhvillimin e një strategjie të integruar kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Strategjia është konceptuar si një kuadër shumë-planësh dhe sistematik, e integruar plotësisht në një politikë kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, me një afat kohor të caktuar, me objektiva realiste, e koordinuar dhe e monitoruar nga një agjenci e vetme (aty ku është e mundur, dhe në përputhje me rregullat vendase), e mbështetur nga burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare dhe e bazuar në njohuritë e sotme shkencore.

Udhëzimet inkurajojnë ngritjen e shërbimeve dhe mekanizmave miqësorë për fëmijën. Ato duhet të mbrojnë të drejtat e fëmijës dhe të ndjekin interesin më të mirë të fëmijëve. Një rekomandim i rëndësishëm flet për raportimin e detyrueshëm nga të gjithë profesionistët përkatës të incidenteve të dhunës ndaj fëmijëve.

Udhëzimet rekomandojnë forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve në mbarë Evropën.



## 2. Qëllimet, fushëveprimi, përkufizimet dhe parimet

### 2.1. Qëllimet

Qëllimet e këtyre udhëzimeve janë për të:

- a. mbrojtur të drejtat e fëmijëve, në veçanti ata që janë viktima të dhunës;
- b. parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve;
- c. nxitur adoptimin, implementimin dhe monitorimin e strategjive të integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna;
- d. përforcuar bashkëpunimin ndërkombëtar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për të mbrojtur fëmijët nga dhuna.

### 2.2. Fushëveprimi dhe përkufizimet<sup>2</sup>

1. Me "Fëmijë" nënkuptohet çdo person nën moshën 18 vjeç, duke përfshirë fëmijët viktima, dëshmitarë dhe autorëve të dhunës.

2. Në përputhje me nenin 19 të KKBDF, "dhuna" përkufizohet si përfshirje e të gjitha formave të dhunës fizike apo mendore, lëndimit dhe abuzimit, neglizhimit dhe trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual.<sup>3</sup> Ky përkufizim përfshin ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës në shtëpi dhe kudo tjetër. Dhuna nënkuptohet që shfaqet jo vetëm mes të rriturve dhe fëmijëve, por edhe ndërmjet fëmijëve.

### 2.3. Parimet

Parimet e përgjithshme

*Mbrojtja ndaj dhunës*

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për t'u mbrojtur kundrejt të gjitha formave të dhunës fizike ose mendore, lëndimeve apo abuzimit, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, keqtrajtimit ose shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, ndërsa ndodhen nën kujdesin e prindit/prindërve, kujdestarit/kujdestarëve ligjorë ose ndonjë personi tjetër i cili ka në kujdes fëmijën.<sup>4</sup>

*E drejta për jetën dhe mbijetesën maksimale dhe zhvillimin*

Çdo fëmijë ka të drejtën e natyrshme të jetës dhe të mbijetesës dhe zhvillimit në shkallën më maksimale të mundshme<sup>5</sup>.

2. Gjithashtu, referoju shtojcës 2 - Fjalori i termave.

3. Gjithashtu, referoju Protokollit Fakultativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve, dhe Protokollin Fakultativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur.

4. Neni 19, KKBDF.

5. Op. cit., neni 6.



# Strategjia e integruar kundër dhunës



## *Mos-diskriminimi*

Të gjithë fëmijët pa dallim gjinie, race, ngjyre, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, origjinë kombëtare apo sociale, lidhje me një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, gjendjeje shëndetësore, invaliditeti apo statusi tjetër, duhet të mbrohen kundrejt të gjitha formave të dhunës dhe tu sigurohet kujdes dhe ndihmë e tillë për të garantuar shkallën maksimale të mundshme për mbijetesën dhe zhvillimin e tyre.

## *Barazia gjinore*

Aspektet gjinore të dhunës duhet të trajtohet si pjesë e qasjes së integruar ndaj dhunës, dhe për këtë duhet të merren parasysh rreziqet e ndryshme që vajzat dhe djemtë hasin në lidhje me dhunën, dhe pasojat e ndryshme të dhunës për djem dhe vajza.

## *Pjesëmarrja e fëmijëve*

1. Fëmijët kanë të drejtë të shprehen lirisht për të gjitha çështjet që ndikojnë në jetën e tyre, dhe, pikëpamjeve të tyre duhet tu kushtohet vëmendja e duhur në varësi të moshës dhe pjekurisë së fëmijës <sup>6</sup>. Pjesëmarrja e fëmijës përfshin në veçanti:
  - a. mbështetjen e fëmijëve për shprehjen e pikëpamjeve të tyre dhe respektimit e marrjes në konsideratë të pikëpamjeve të fëmijës në të gjitha situatat që ndikojnë atë;
  - b. sigurimin e mundësisë për fëmijën për t'u dëgjuar në çdo procedurë gjyqësore, administrative ose jashtëgjyqësore.
2. Fëmijët duhet të angazhohen në mënyrë aktive e tu jepet autoriteti, në përputhje me kapacitetin e zhvillimit dhe me pëlqimin e tyre të dhënë për të marrë pjesë në mënyrë të plotë në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve për të parandaluar dhunën. Shteti dhe të tjerë aktorë të përshtatshëm duhet të dëgjojnë me kujdes pikëpamjet e fëmijëve në dritën e kontributit që mund të sjellë perspektiva e fëmijës për cilësinë e zgjidhjeve që merren nën shqyrtim.

## *Detyrimet e shtetit*

1. Shteti ka përgjegjësinë kryesore për të mbështetur të drejtat e fëmijës dhe për të mbrojtur të gjithë fëmijët brenda juridiksionit të tij nga të gjitha format e dhunës, sado të të buta të jenë, në të gjitha kohërat dhe në të gjitha vendndodhjet <sup>7</sup>. Shtetet duhet të investojnë në politika dhe programe të bazuar mbi të dhëna, të udhëhequr nga interesat më të mira të fëmijës, të trajtojnë faktorët që ndikojnë në rritje të dhunës dhe të përgjigjen në mënyrë efektive kur ndodh dhuna.

6. Op. cit, Neni 12.

7. Ibid., Neni 19.





2. Duke pranuar rolin qendror që familjet luajnë në zhvillimin dhe mirëqënien e fëmijëve dhe në ruajtjen e të drejtave të tyre, duke përfshirë të drejtën për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, shteti duhet të mbështesë familjet në rolin e tyre të rritjes së fëmijës duke:
  - a. siguruar një rrjet të arritshëm, fleksibël dhe cilësor shërbimesh për kujdesin e fëmijës <sup>8</sup> ;
  - b. lehtësuar pajtimin pozitiv të familjes dhe jetës në punë;
  - c. hartuar programe për të përmirësuar aftësitë prindërore dhe për të nxitur një mjedis të shëndetshëm dhe pozitiv familjar <sup>9</sup> ;
  - d. inkorporuar një perspektivë të të drejtave të fëmijës në të gjitha nivelet e procesit buxhetor.

### *Përgjegjësitë dhe pjesëmarrja e aktorëve të tjerë*

Përgjegjësia për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve shtrihet në të gjitha shërbimet, institucionet dhe profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, prindërit dhe familjet e mëdha, mediat, sektori privat, komunitetet fetare dhe shoqëria civile.

### *Interesat më të mira të fëmijës*

Në të gjitha veprimet që ndikojnë në fëmijët, duke përfshirë ato për t'i mbrojtur ata nga të gjitha format e dhunës, duhet të konsiderohen parësore interesat më të mirë të fëmijës.

### **Parimet operative**

1. Dhuna ndaj fëmijëve është multidimensionale. Kjo qasje presupozon se duhet të ketë një kombinim të faktorëve që dhuna të ndodhë, të përsëritet, ose të ndalojë. Ajo bën thirrje për trajtimin tërësor të rrethanave të incidentit të dhunshëm, në bazë të ndërvarësisë së tyre, jo të trajtohet vetëm si një marrëdhënie shkak-pasojë.
2. Parandalimi i dhunës kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndër-sektorial. Kjo përfshin në veçanti, bashkërendimin e të gjithë departamenteve të qeverisë qendrore, në të gjithë krahinat dhe rajonet, dhe midis qeverisë dhe shoqërisë civile.
3. Dhuna ndaj fëmijëve kërkon një qasje të integruar (sistemike, holistike). Kjo qasje lejon që faktorët e shkallëve të ndryshme (kulturore, psikologjike, pedagogjike, sjelljes, fizike, politike, socio-ekonomike, etj) të trajtohen mbi bazën e argumentave të përbashkëta. Kjo nënkupton që të gjitha programet dhe veprimet që synojnë parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, në kontekstin e gjerë të promovimit të të drejtave të fëmijës, duhet të veprojnë nëpër një sërë disiplinash dhe sektorësh. Në të njëjtën frymë, seksionet e udhëzimeve janë të ndërlidhura dhe duhet të lexohen së bashku me njëri-tjetrin.

8. Referoju Rekomandimit Rec (2002) 8 të Komitetit të Ministrave mbi kujdesin ditor për fëmijët.

9. Referoju Rekomandimit Rec (2006) 19 të Komitetit të Ministrave për politikën në mbështetje të prindërimit pozitiv.



4. Një qasje me shumë aktorë është e domosdoshme për çrrënjosjen e dhunës ndaj fëmijëve, pasi kjo është një përgjegjësi që shtrihet përtej organeve dhe shërbimeve të kontrolluara nga shteti për të përfshirë të gjithë anëtarët e shoqërisë, të tilla si institucionet e shtetit, autoritetet lokale, organizatat jo-qeveritare, profesionistët, mediat, familjet dhe fëmijët. Në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve dhe veprimeve për të mbrojtur fëmijët nga dhuna prioritet i duhet dhënë: :
  - a. ndërtimit të partneriteteve midis familjeve dhe shtetit, duke u bazuar në besimin dhe respektimin e kulturave dhe traditave të ndryshme;
  - b. angazhimit në dialog të vërtetë me fëmijët dhe ndërtimit progresivisht të një kulture të respektit për pikëpamjet e fëmijëve, duke përfshirë informimin e tyre mbi rezultatet e proceseve dhe duke u shpjeguar se si mendimet e tyre janë marrë parasysh.

### 3. Aksioni i integruar kombëtar, rajonal dhe lokal

#### 3.1. Strategjitë e integruara kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna

1. Një kuadër multidisiplinor dhe sistematik (të referuar më poshtë si "strategji") i integruar në procesin e planifikimit kombëtar, bazuar në KKBDF-në dhe afrimin e të gjitha palëve të interesuara, paraqet përgjigjen më efektive kundrejt dhunës ndaj fëmijëve që është e qëndrueshme në kohë. Element bazë i strategjisë duhet të jetë një kompleks i efektshëm dhe i plotë masash parandaluese parësore, dytësore dhe tretësore që fokusohen te fëmijët e familjet e që janë multidisiplinore dhe të orientuara drejt plotësimit të nevojave të fëmijëve dhe familjeve.<sup>10</sup> Strategjia duhet të përmbajë objektiva realiste dhe të arritshme në një periudhë kohe të caktuar, të mbështetet nga burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare, të bazohet në njohuritë aktuale shkencore (në lidhje me atë që është provuar se funksionon) dhe të vlerësohet sistematikisht.
2. Strategjia duhet të mbështetet në bashkëpunimin dhe koordinimin ndër-sektorial duke përfshirë shëndetësinë, arsimin dhe sektorët socialë, agjensitë përgjegjëse për planifikimin dhe përshtatjen e buxhetit, autoritetet e zbatimit të ligjit, dhe sistemin e drejtësisë. Në nivel kombëtar, një agjensi me përgjegjësi kryesore për mbrojtjen e fëmijëve ndaj dhunës duhet të marrë (nëse është e mundur dhe në pajtim me rregullat kombëtare) një rol kryesor koordinimi dhe monitorimi. Kapaciteti i saj për të përfshirë sektorë të shumëfishtë në një veprim me bazë të gjerë është vendimtar për suksesin afatgjatë të strategjisë.

10. Puna parandaluese e drejtuar ndaj shoqërisë në përgjithësi njihet si parandalimi primar. Ajo parandalon dhunën duke adresuar çështje të gjera, të tilla si shëndetësia apo arsimit, dhe zvogëlon faktorët e rrezikut, të tilla si papunësia dhe përjashtimi shoqëror. Fëmijët të cilët kanë një rrezik të lartë për të qenë subjekt i dhunës, ose që shkaktojnë dhunë mbi të tjerë janë objekt i parandalimit dytësor. Këtu përfshihen masat për fëmijët që abuzojnë me drogat dhe alokolin, etj. Parandalimi tretësor përpiqet të parandalojë, ndryshojë ose kufizojë pasojat e dhunës që ka ndodhur tashmë. Ai fokusohet mbi rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave dhe shkaktarëve të dhunës.




## Strategjia e integruar kundër dhunës



3. Të gjithë aktorët që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të tilla si autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, familjet, institucionet e pavarura për të drejtat e njeriut, profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, studiuesit, shoqëria civile dhe mediat duhet të jenë të përfshirë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjisë. Fëmijët nuk duhet vetëm të dëgohen, por të fuqizohen për të kontribuar, me marrjen e pëlqimit të tyre dhe në përputhje me kapacitetin e tyre, në veprime ku përfshihen shumë aktorë. Për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të fëmijëve duhet të vihen në dispozicion burime të mjaftueshme.
4. Duhet të zhvillohen metodologji për të vlerësuar përparimin dhe aksionet e parashikuara nga strategjia në të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe nivelin ndër-sektorial. Vlerësimet duhet të kryhen rregullisht me qëllim identifikimin e politikave dhe masave që janë të përshtatshme dhe efektive në parandalimin dhe trajtimin e dhunës.
5. Informacioni mbi zbatimin e strategjisë duhet të shpërndahet gjerësisht. Dukshmëria e veprimeve të ndërmarra për të parandaluar dhe për të adresuar dhunën duhet të rritet, ndër të tjera, nëpërmjet diskutimeve të tyre në forumet e zgjedhura në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

### 3.2. Aksioni rajonal dhe lokal

1. Aksioni lokal për të parandaluar dhunën është veçanërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh afërsinë e tij me fëmijët dhe familjet si përfitues finalë të shërbimeve. Në këtë nivel personat e interesuar do duhet të marrin ndihmë, në përputhje me nevojat dhe karakteristikat e tyre.
2. Ndërsa autoritetet kombëtare vendosin standarde të përbashkëta për ofrimin e shërbimeve, është përgjegjësi e rajoneve dhe bashkive ti përmbahen këtyre standardeve dhe të sigurojnë një rrjet të mekanizmave dhe shërbimeve miqësore për fëmijët. Përgjegjësitë e autoriteteve rajonale dhe lokale gjithashtu përfshijnë mbledhjen e të dhënave mbi dhunën ndaj fëmijëve, zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e masave parandaluese; financimin dhe dhënien e ambjenteve për veprimtari; etj.
3. Autoritetet kombëtare dhe rajonale duhet të ofrojnë përkrahjen e duhur në programet lokale për parandalimin e dhunës në aspektin e financimit, trajnimit, vlerësimit dhe vijueshmërisë. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet këtyre niveleve janë të domosdoshëm për përmirësime të vazhdueshme në ofrimin e shërbimeve dhe optimizimin e burimeve.






4. Duhet të mbështeten ndërhyrjet e Komunitetit për të parandaluar dhunën ndaj fëmijëve, përfshirë të gjithë sektorët dhe palët e interesuara. Ndërhyrje të tilla mund të kryhen nëpërmjet platformave të hapura, këshilleve apo rrjeteve duke sjellë së bashku, për shembull, autoritetet komunale, sociale dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor, shkollat, institucionet e gjyqësorit në nivel lokal, policinë, shoqatat e emigrantëve apo të komunitetit, organizatat me bazë fetare dhe fëmijët dhe familjet.<sup>11</sup>
5. Duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi mes bashkive (dhe rajoneve), duke përfshirë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mirat.
6. Duhet të promovohet rregullimi në mënyrë të përshtatshme dhe përfshirja e monitoruar e sektorit privat dhe organizatave jo-qeveritare.
7. Ndërsa decentralizimi në shkallë të gjerë dhe privatizimi i shërbimeve sociale janë tanimë të zakonshme në shtetet evropiane, kapacitetet e autoriteteve rajonale dhe lokale për të kontribuar në zbatimin e strategjisë duhet të vlerësohen me kujdes.

## 4. Ndërtimi i një kulture për respektimin e të drejtave të fëmijës

Strategjia duhet të ketë si objektivi kryesor ndryshimin cilësor në perceptimin e fëmijëve dhe fëmijërinë, dhe të dhunës ndaj fëmijëve. Ky objektivi mund të arrihet vetëm kur të gjitha segmentet e shoqërisë të jenë bërë mjaftueshëm të vetëdijshëm për të drejtat e fëmijës dhe për ndikimin e dëmshëm të dhunës mbi fëmijët, kur kulturat dhe praktikat organizative në këtë drejtim të jenë forcuar, dhe kur urat e ndërtuara ndërmjet profesioneve të përballojnë një mbrojtje më të mirë për fëmijët, kur të jenë transformuar mentalitetet, nëpërmjet mjeteve të informacionit dhe teknologjive të komunikimit; kur të jenë trajtuar kushtet themelore ekonomike dhe sociale që shoqërohen me dhunë - me fjalë të tjera, kjo është e mundur vetëm kur një kulture të mirëfilltë e respektit për të drejtat e fëmijës ka përshkuar strukturën e shoqërisë.



11. Gjithashtu referoju manualit "Parandalimi i dhunës në shkollë: një manual për partneritete lokale" (Këshilli i Evropës, 2005).



## 4.1. Arsimi dhe rritja e ndërgjegjësimit

1. Është një detyrim i shtetit për të bërë të njohur gjerësisht informacionin mbi të drejtat e fëmijës, si për për fëmijët ashtu dhe të rriturit, me mjete të përshtatshme dhe aktive<sup>12</sup> Kjo përfshin në veçanti:
  - a. përfshirjen e të drejtave të fëmijës në programet shkollore dhe promovimin e një qasjeje për të drejtat e fëmijës në të gjitha nivelet e arsimit;
  - b. trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për të drejtat e fëmijës për të gjithë ata që punojnë me dhe për fëmijët;
  - c. rritjen e ndërgjegjësimit, me anë të mjeteve të informimit publik dhe fushatave mediatike, për të drejtat e fëmijës, duke përfshirë të drejtën për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, të drejtën e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik dhe të drejtën për t'u dëgjuar dhe marrë seriozisht mendimi.
2. Duhet të promovohet në të gjithë shoqërinë një intolerancë e qartë dhe e padiskutueshme ndaj të gjitha formave të dhunës kundrejt fëmijëve, sado të vogla qofshin. Qëndrimet publike të rrënjësura në normat dhe traditat sociale dhe kulturore të cilat pranojnë, harrojnë apo mbështesin dhunën, duke përfshirë rolet stereotipike gjinore, diskriminimin racor ose etnik, pranimin e ndëshkimit trupor dhe praktika të tjera tradicionale të dëmshme duhen dënuar dhe eliminuar publikisht. Efektet e dëmshme që kanë të gjitha format e dhunës mbi fëmijët duhet të bëhen të njohura gjerësisht. Duhet të përforcohet kuptimi i detyrimeve të shtetit dhe përgjegjësisë individuale për të dënuar dhe parandaluar dhunën dhe për të ndihmuar fëmijët që janë viktimë.
3. Duhet të forcohen me të gjitha mjetet njohuritë e prindërve dhe kujdestarëve të fëmijëve mbi të drejtat e fëmijës dhe prindërimin pozitiv, duke përfshirë inkurajimin për regjistrimin e tyre në programet e prindërimin pozitiv.

## 4.2. Trajnimi profesional

1. Trajnimi i profesionistëve që punojnë për dhe me fëmijët përfaqëson një investim të rëndësishëm afatgjatë në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Për këtë arsye, shteti dhe shoqëria duhet të vlerësojnë këto profesione duke i atribuar atyre format e nevojshme morale, financiare dhe të tjera të mbështetjes publike dhe private.
2. Është obligim i shtetit për të rrënjësuar kulturën e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësinë ndaj fëmijëve tek të gjithë profesionistët që janë në kontakt me fëmijët përmes punës së tyre (për shembull, punonjësit socialë, kujdestarët, oficerët e policisë, gjykatësit, mësuesit, drejtorët e shkollave, personat që punojnë me të rinjtë, të punësuarit nga institucionet e paraburgimit dhe institucionet e kujdesit të fëmijës, personat që merren me çështjet e migrimit dhe ndihmën humanitare, trajnerët e sportit, etj). Për të promovuar njohuritë për të drejtat e fëmijës, duhet të integrohen kurse përkatëse në kurrikulat universitare dhe të trajnimit.

<sup>12</sup> Neni 42, KKBDP.





3. Të gjithë profesionistët përkatës që në punën e tyre janë në kontakt me fëmijët duhet të jenë njohur me KKBDF dhe metodologjitë dhe qasjet, duke përfshirë ato që kërkohen për të dëgjuar fëmijët në mënyrë efektive, dhe të jenë të trajnuar për të punuar në një mjedis të ndryshëm etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.
4. Të gjithë profesionistët përkatës duhet të ketë aftësi për të parandaluar, zbuluar dhe për t'iu përgjigjur efektivisht dhunës ndaj fëmijëve. Për këtë qëllim, rregullat e kurrikulës kombëtare duhet të përfshijnë trajnimin e detyrueshëm dhe të vazhdueshëm për parandalimin, identifikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës ndaj fëmijëve, si dhe mbrojtjen dhe vazhdimësinë e kujdesit ndaj fëmijëve. Trajnimi duhet të ndjekë një qasje gjithëpërfshirëse dhe t'i japë përparësi identifikimit të hershëm të risqeve potenciale ndaj mirëqënies së fëmijës.
5. Profesionistëve që punojnë për dhe me grupet e rrezikuara të fëmijëve, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara, duhet t'u ofrohen trajnime të specializuara.<sup>13</sup>
6. Duke patur parasysh shpeshherë mjedisin e vështirë fizik dhe psikologjik që rrethon shërbimet që asistojnë fëmijët e prekur nga dhuna, i duhet të dhënë mbështetja e duhur personelit të tyre në lidhje me mbikëqyrjen, këshillimin, trajnime plotësuese dhe mundësinë e krijimit të grupeve të interesit profesional.

### 4.3. Medya ve bilgi toplumu

1. Mediat e lira dhe të pavarura, në përputhje të plotë me sistemin e tyre vetërregullues, mund të luajnë një rol të fuqishëm në ndërtimin e një kulturë të respektimit të të drejtave të fëmijës dhe të veprojnë si partnerë të natyrshëm në zbatimin e strategjisë. Mediat duhet të inkurajohen për të edukuar si fëmijët, dhe të rriturit për të drejtat e fëmijës, të promovojnë pjesëmarrjen e fëmijëve, të mbështesin praktikatat e prindërimit pozitiv, të forcojnë dialogun ndërkulturor dhe ndër fetar, dhe të nxisin vlerat jo të dhunshme në shoqëri<sup>14</sup>.
2. Shteti mban përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e fëmijëve ndaj përmbajtjes së dëmshme të medias dhe për promovimin e pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në mjedisin e informimit dhe komunikimev<sup>15</sup>.

13. Referojuni Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Rekomandimit Rec (2006) 5 të Komitetit të Ministrave mbi Planin e Veprimit të Këshillit të Evropës për të promovuar të drejtat dhe pjesëmarrjen e plotë të njerëzve me aftësi të kufizuara në shoqëri: përmirësimi i cilësisë së jetës të njerëzve me aftësi të kufizuara në Evropë 2006-2015.

14. Referojuni Rekomandimit Nr R (97) 19 të Komitetit të Ministrave për portretizimin e dhunës në media elektronike dhe Rekomandimit të Asamblesë Parlamentare Këshillit të Evropës 1466 (2000) mbi "Edukimin e mediave".

15. Referojuni rekomandimeve CM / Rec (2009) 5 të Komitetit të Ministrave mbi masat për të mbrojtur fëmijët ndaj përmbajtjes dhe sjelljes së dëmshme dhe për të promovuar pjesëmarrjen e tyre aktive në mjedisin e ri të informimit dhe komunikimit, dhe CM / Rec (2008) 6 mbi masat për të promovuar respektin për lirinë e shprehjes dhe informacionin në lidhje me filtrat e internetit, Deklaratës së vitit 2008 të Komitetit të Ministrave mbi mbrojtjen e dinjitetit, sigurisë dhe privatësisë së fëmijëve në internet, Vendimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në rastin e KU vs. Finlandës (2009), kërkesa nr 2872/02, dhe vendimi i pranueshmërinë në rastin Perrin vs. Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr 5446/03.



## Strategjia e integruar kundër dhunës



3. Në lidhje me portretizimin e dhunës dhe shpërndarjen e përmbajtjes potencialisht të dëmshme për fëmijët, ata që janë përgjegjës për mediat duhet të marrin përsipër plotësisht detyrat dhe përgjegjësitë e tyre që përfshin ushtrimin e lirisë së shprehjes. Kjo mund të bëhet përmes heqjen ose bllokimit të aksesit në materiale të papërshtatshme, ose përmes zhvillimit të sistemeve të automatizuara për vlerësimin e përmbajtjes, miratimin e kodeve të sjelljes dhe standardeve për vlerësimin e përmbajtjes, ngritjen e mekanizmave të kontrollit, krijimin e sistemeve të ankesave për përmbajtjen, etj. <sup>16</sup>.
4. Në mënyrë që të përmbushin pritshmëritë e fëmijëve dhe familjeve për shërbimet e internetit në mënyrë të aksesueshme, të sigurt dhe të besueshme, ofruesit e shërbimit internet duhet të inkurajohen për të dhënë informacion mbi rreziqet e mundshme të të drejtave të klientëve të tyre, sigurinë dhe privatësinë online në internet <sup>17</sup>. Duhet të forcohet bashkëpunimi me autoritetet e zbatimit të ligjit në hetimin e krimeve të kryera përmes përdorimit të teknologjive të telekomunikacionit <sup>18</sup>.
5. Duke pasur parasysh ndikimin e mundshëm të lojrave online në internet për të drejtat dhe sensibilitetin e fëmijëve, hartuesit e lojrave dhe botuesit e tyre duhet të inkurajohen që të vlerësojnë rregullisht politikatat dhe praktikatat në lidhje me sigurinë e fëmijës <sup>19</sup>.
6. Mediat duhet të inkurajohen për të ndërtuar partneritetet me të gjithë aktorët respektivë në mënyrë që të :
  - a. zhvillojnë aftësitë e përdorimit nga fëmijët të literaturës mediatike <sup>20</sup> ;
  - b. punojnë me ekspertët për sigurinë e fëmijës, hartuesit e politikave, shërbimet sociale dhe autoritetet e zbatimit të ligjit për të zhvilluar, inkorporuar dhe monitoruar zbatimin e teknologjive të reja për të mbrojtur fëmijët kundrejt dëmit që vjen nga përdorimi i internetit ;
  - c. rrisin ndërgjegjësimin e profesionistëve të medias për të drejtat e fëmijës dhe dhunës kundër fëmijëve.
7. Prindërit dhe mësuesit kanë një përgjegjësi të veçantë sa i përket aksesit dhe përdorimit të mediave në shtëpi dhe në shkollë. Ata mund të marrin këtë përgjegjësi në mënyra të ndryshme, duke përfshirë përdorimin e vetëdijshëm dhe selektiv të medias, nxitjen e qëndrimeve kritike të fëmijëve, kufizimin e aksesit në përmbajtjen që mund të ndikojë negativisht në mirëqenien fizike, emocionale ose psikologjike të fëmijëve, etj.
8. Duhet të inkurajohet dhe mbështetur fuqimisht krijimi i mediave nga fëmijët dhe me fëmijët, për qëllime që përfshijnë eliminimin e dhunës.

16. Referoju gjithashtu Rekomandimit Rec (2001) 8 të Komitetit të Ministrave mbi vetë-rregullimin që ka të bëjë me përmbajtjen kibernetike.

17. Udhëzimet e Këshillit të Evropës për të ndihmuar ofruesit e shërbimeve të internetit të kuptojnë praktikisht, dhe përputhjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore kryesore në shoqërinë e informacionit, në veçanti në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2008).

18. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, K.U. vs. Finlandës, 2009.

19. Referojuni Udhëzimeve të Këshillit të Evropës për të ndihmuar ofruesit e lojrave online të kuptojnë praktikisht, dhe përputhjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në shoqërinë e informacionit, në veçanti në lidhje me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2008).

20. Referojuni Rekomandimit Rec (2006) 12 të Komitetit të Ministrave mbi fuqizimin e fëmijëve në mjedisin e ri të informacionit dhe komunikimit.



## 5. Kuadrot e ndryshme

### 5.1. Kuadri ligjor

#### *Pajtueshmëria me KKPDF-në dhe standardet e tjera ndërkombëtare*

1. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë palë të KKPDF-së dhe janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e saj dhe të veprojnë në përputhje me parimet e saj. Të gjitha rezervat që janë të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e KKPDF-së duhet të tërhiqen.
2. Në nivelet globale dhe rajonale janë miratuar instrumente të shumta për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe për mbrojtur fëmijët kundrejt formave të ndryshme të dhunës <sup>21</sup>. Anëtarësimi në këto traktate duhet të inkurajohet fuqimisht. Pasi të jenë ratifikuar, ato duhet të zbatohen në mënyrë efektive dhe të monitorohen, dhe duhet të sillen në përputhje me to ligjet kombëtare, aktet nënligjore, politikat, rregulloret, planet dhe programet.

#### *Parandalimi*

Kuadri kombëtar ligjor duhet t'i japë prioritet parandalimit të dhunës dhe të mbrojtë të drejtat e fëmijës duke marrë masa të tilla si:

- a. Regjistrimi i fëmijëve menjëherë pas lindjes, në varësi të rregulloreve kombëtare dhe detyrimeve ndaj shtetit sipas traktateve përkatëse ndërkombëtare në këtë fushë; <sup>22</sup>
- b. vendosja e një moshe minimale për martesë që nuk është shumë e ulët dhe që është e aplikueshëm si për djemtë dhe për vajzat ;
- c. vendosja e një moshe minimale për pëlqimin seksual;
- d. ndalimi i punësimit në pozicionet që përfshijnë mbikëqyrjen e fëmijës nga ana e personave të dënuar për vepra penale të dhunshme, përfshirë ato seksuale, ndaj fëmijëve;
- e. zhvillimi i programeve të ndërhyrjes dhe masave për të vlerësuar dhe parandaluar rrezikun e kryerjes së dhunës ndaj fëmijëve;
- f. hartimi i një sistemi të shqyrtimit të plotë të atyre që punojnë me fëmijët, në çdo cilësi, që siguron një balancë të përshtatshme mes të drejtës së fëmijës për mbrojtjen nga dhuna dhe të drejtës së individit për një emër të mirë; <sup>23</sup>
- g. integrimi në ligjet kombëtare të një detyrimi për të respektuar të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për t'u atribuar rëndësinë e duhur pikëpamjeve të fëmijëve.

21. Lista e gjerë e traktateve relevante ndërkombëtare paraqitet në Shtojcën 3. Shtojca 4 paraqet listën e rekomandimeve të miratuara nga organet e Këshillit të Evropës (Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës).

22. Referojuni Nenit 7, KKPDF.

23. Referojuni, për shembull, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, White, vs. Suedisë, 2006, dhe Leander vs. Suedisë, 1987.



## Ndalimi i dhunës

Shteti ka një detyrim të qartë për të siguruar të drejtën e fëmijëve për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, sado e vogël qoftë. Masat e duhura legislative, administrative, shoqërore dhe arsimore duhet të merren për të ndaluar të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve në të gjitha kohërat dhe në të gjitha mjediset dhe për të siguruar mbrojtjen e të gjithë fëmijëve brenda juridiksionit të shtetit. Mbrojtjet ligjore dhe autorizimet për çdo formë të dhunës, duke përfshirë atë për qëllime korrektimi, disipline ose ndëshkimi, brenda ose jashtë familjeve, duhet të shfuqizohen <sup>24</sup>. Ndalimi duhet të mbulojë domosdoshmërisht:

- a. të gjitha format e dhunës seksuale dhe abuzimit, korrupsionit me fëmijët dhe joshjen e fëmijëve për qëllime seksuale;
- b. të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve, duke përfshirë prostitucionin e fëmijëve, pornografinë e fëmijëve, shfrytëzimin seksual në udhëtim dhe turizëm, trafikimin, shitjen e fëmijëve, adoptimin e paligjshëm, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë dhe praktikatat e ngjashme me të, heqjen e organeve, për çdo qëllim ose në çdo formë; <sup>25</sup>
- c. të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve përmes përdorimit të teknologjive të reja;
- d. gjitha praktikatat e dëmshme tradicionale apo zakonore, të tilla si martesat e hershme ose të detyruara, vrasja për nder dhe gjymtimi gjeneral;
- e. ekspozimin e fëmijëve ndaj përmbajtjes së dhunshme apo të dëmshme, pavarësisht nga origjina e saj dhe mjeti i transmetimit;
- f. të gjitha format e dhunës në institucionet rezidenciale <sup>26</sup> ;
- g. të gjitha format e dhunës në shkollë;
- h. të gjithë format e ndëshkimit trupor dhe trajtimit tjetër mizor, çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit të fëmijëve, si fizik ashtu dhe psikologjik <sup>27</sup> ;
- i. ekspozimit të fëmijëve ndaj dhunës në familje dhe në shtëpi.

## Roli i aktorëve të komunitetit

Duhet të merren masat e nevojshme legislative apo të tjera të ngjashme për të siguruar që personat juridikë të mund të bëhen përgjegjës për veprat penale të kryera sipas nenit 26 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimit dhe

24. Referojuni Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut, në vendimin e pranueshmërisë në rastin e Shtatë Individëve vs. Suedisë, 1982, kërkesa nr 8811/79, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Tyrer vs., 1978, Campbell dhe Cosans vs. Mbretërisë së Bashkuar, 1982; A. vs. Mbretërisë së Bashkuar, 1998; vendimi i pranueshmërisë në rastin e Philip Williamson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2000, kërkesa nr 55211/00.

25. Gjithashtu referoju Konventës së Këshillit të Evropës për Aksionin kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore (CETS Nr 197, 2005/2008), Konventës së Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (CETS Nr 201) , nenet 32, 34, 35, 36 të KKBDF-së dhe Protokollit të Palermos, si dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Konventa lidhur me Moshën Minimale për Pranimin në Punësim dhe Punë (ILO C.138) dhe Konventa lidhur me Ndalimin dhe Veprimin e Menjëhershëm për Eliminimin e Formave më të Këqija të Punës së Fëmijëve (ILO C. 182).

26. Referoju Rekomandimit CM / Rec (2005) 5 të Komitetit të Ministrave për të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione rezidenciale.

27. Shih shënimin 22. Gjithashtu referoju Komitetit Evropian për të Drejtat Sociale, Vëzhgime të Përgjithshme në lidhje me nenet 7 (paragrafi 10) dhe 17, Përfundimet XV-2, Vol. 1, Hyrje e përgjithshme, f. 26..



## Strategjia e integruar kundër dhunës




Abuzimit Seksual (CETS Nr 201).

### *Sanksionet dhe masat*

1. Veprat penale të dhunshme ndaj fëmijëve, duke përfshirë ato seksuale, duhet të dënohen me sanksione dhe masa efektive, proporcionale dhe bindëse, duke pasur parasysh seriozitetin e veprës <sup>28</sup>.
2. Personave që dënohen për vepra penale të dhunshme ndaj fëmijëve, duke përfshirë personat subjekt të procedurave penale, duhet t'u ofrohet akses në programet dhe masat e ndërhyrjes efektive me qëllim parandalimin dhe minimizimin e risqeve për përsëritjen e veprës penale <sup>29</sup>.
3. Çdo sistem drejtësie që merret me fëmijë autorë të dhunës duhet të integrohet me iniciativa më të gjera sociale që synojnë një qasje të plotë dhe vazhdimësi të kujdesit ndaj këtyre fëmijëve në përputhje me parimet e integritit social dhe arsimimit dhe parandalimit të përsëritjes së veprës penale ( parimi i përfshirjes së komunitetit dhe kujdesit të vazhdueshëm) <sup>30</sup>.
4. Sistemi ligjor kombëtar, në përputhje me parimet e tij themelore, duhet të ofrojë mundësinë për të mos imponuar dënime mbi fëmijët viktime të dhunës si shkak i përfshirjes së tyre në aktivitete të paligjshme, në masën që ato janë të detyruar për ta bërë këtë.

### *Rrethanat rënduese*

Përdorimi i dhunës ndaj fëmijëve duhet të merret në konsideratë si një rrethanë rënduese në përcaktimin e një sanksioni. Rrethana të tjera që duhet të merren parasysh, për aq sa ato nuk bëjnë pjesë në elementët përbërës të veprës, duhet të përfshijnë abuzimin me një pozicion të pranuar besimi, autoriteti apo influence mbi fëmijën, të bazuar në një marrëdhënie ekonomike apo ndonjë formë tjetër të varësisë, si dhe përfshirjen në një organizatë kriminale <sup>31</sup>.



28. Shih, për shembull, Neni 27, Konventa e Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual.

29. Shih, për shembull, op., cit., Nenet 15, 16 dhe 17.

30. Referoju Rekomandimit CM / Rec (2008) 11 të Komitetit të Ministrave mbi Rregullat Evropiane për shkolësit e mitur subjekt i sanksioneve ose masave.

31. Gjithashtu, referoju nenit 28 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual.



## *Juridiksioni*

1. Masa të nevojshme legislative apo të tjera duhet të merren për të vendosur juridiksionin mbi veprat penale të dhunshme ndaj fëmijëve, duke përfshirë ato seksuale, të cilët janë nënshetas ose kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në territorin e shtetit.
2. Në varësi të kërkesave të traktateve ndërkombëtare, duhet të merren masat e nevojshme legislative apo të tjera për të vendosur juridiksionin kombëtar mbi veprat penale të dhunshme ndaj fëmijëve, duke përfshirë ato seksuale, të kryera jashtë vendit nga nënshetasit dhe personat të cilët kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në territorin e shtetit <sup>32</sup>. Për të siguruar legjislacionin efektiv jashtë-territorial, ndjekjen penale të autorëve dhe vënien e sanksioneve, duhet të hiqet kërkesa e kriminalitetit të dyfishtë dhe duhet lehtësuar asistenca ligjore reciproke.

## *Statusi i kufizimit*

Në lidhje me shkeljet e identifikuara nga Neni 33 i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual, statusi i kufizimit duhet të vazhdojë për një periudhë kohore e cila të jetë e mjaftueshme për të mundësuar fillimin me efikasitet të procedurave pasi fëmija viktimë ka arritur moshën madhore dhe proporcionale me seriozitetin e krimit në fjalë.

## *Zbatimi*

Legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës duhet të zbatohet në mënyrë të plotë dhe adekuate. Për këtë qëllim, ai duhet të mbështetet nga institucionet përkatëse, duke përfshirë institucionet e pavarura kombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe mekanizmat e pavarur të monitorimit, burimet njerëzore dhe financiare, dhe të shoqërohet me udhëzime për të gjithë sektorët dhe profesionistët përkatës <sup>33</sup>.

## *5.2. Kuadri i politikave*

### *Politika kombëtare për të drejtat e fëmijës*

1. Ekzistenca e një politike kombëtare për të drejtat e fëmijës është vendimtare për realizimin e së drejtës së fëmijës për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës. Një politikë e tillë inicon, promovon dhe koordinon proceset që synojnë të sigurojnë që dispozitat dhe parimet e KKBDF-së të përshkojnë të gjitha aspektet e politikës qeveritare dhe të gjitha aksionet publike që ndikojnë mbi fëmijët.

32. Referoju, op. cit., nenit 25.

33. Shih jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke përfshirë rastin e A. vs. Mbretërisë së Bashkuar, 1998, dhe Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2001, të cilat i kërkojnë shteteve të sigurojnë mbrojtje adekuate ligjore të fëmijëve nga trajtimi që është çnjerëzor dhe poshtërues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



## Strategjia e integruar kundër dhunës



2. Të gjitha politikat kombëtare, të rëndësishme për mirëqënien e fëmijëve (politika sociale, politika e kujdesit shëndetësor, politika arsimore, politika e strehimit, etj) duhet të kontribuojnë në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Prioritet duhet t'i jepet politikave që synojnë reduktimin e pabarazisë, varfërisë dhe marginalizimit, mbështetjen e familjeve, trajtimin e papunësisë dhe boshllëkut në të ardhura; trajtimin e tolerancës, besimeve dhe vlerave sociale që tolerojnë dhe mbështesin dhunën, përmirësimin e rrjeteve sociale, lehtësimin e përfshirjes sociale të emigrantëve dhe familjeve të tyre. Politikat dhe masat e zhvilluara në fushat përkatëse duhet të koordinohen siç duhet, dhe rezultatet e tyre duhet të jenë reciprokisht përforcuese.
3. Duhet të zhvillohen politikat, e bazuara në hulumtime, të dhëna dhe vetë përvojat e fëmijëve, për të parandaluar, zbuluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës ndaj fëmijëve. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së grupeve të rrezikuara, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara<sup>34</sup>, fëmijët që janë apo kanë përjetuar kujdesin e shtetit<sup>35</sup>, fëmijët në kujdestari, fëmijët e braktisur<sup>36</sup>, fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë<sup>37</sup>, fëmijët refugjatë dhe azil kërkues<sup>38</sup>, fëmijët që u përkasin minoriteteve, fëmijët që punojnë dhe/ose që jetojnë në rrugë<sup>39</sup>, fëmijët që jetojnë në varfëri ekstreme dhe zona të pafavorizuara ose të veçuara<sup>40</sup>, fëmijët në konflikte të armatosura dhe situata të jashtëzakonshme<sup>41</sup>, fëmijët në paraburgim ose në konflikt me ligjin<sup>42</sup>, etj.

### *Politikat e fëmijëve dhe familjeve*

1. Qëllimi i përgjithshëm i politikave për fëmijët dhe familjet duhet të jetë:
  - a. të mbështesë familjet në përgjegjësitë e tyre për rritjen e fëmijëve;
  - b. të parandalojë, aq sa është e mundur, ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre;
  - c. të sigurojë alternativa të ngjashme me familjen dhe me bazë komunitare për vendosjen e fëmijëve në institucionet që janë në interesin më të mirë të fëmijës.
  - d. në rastet e ndarjes dhe, kur është e përshtatshme, të sigurojë kontakt të vazhdueshëm ndërmjet fëmijëve dhe prindërve të tyre dhe të mbështesë ribashkimin familjar kur është në interesin më të mirë të fëmijës.
2. Promovimi i formave pozitive dhe jo të dhunshme të rritjes së fëmijës duhet të jetë kryesor në politikat e fëmijëve dhe familjes. Prindërimi pozitiv ka të bëjë me sjellje

34. Referoju Komitetit të Ministrave, Rekomandimi Rec (2006) 5, të cituar më lart, dhe "Mbrojtja e të rriturve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara ndaj abuzimit", Këshilli i Evropës, 2003.

35. Referoju Komitetit të Ministrave, Rekomandimi Rec (2005) 5, të cituar më sipër.

36. Referoju Rekomandimit të Asamblesë Parlamentare 601 (2003) mbi "Përmirësimin e grupit të fëmijëve të braktisur në institucione".

37. Referoju Rekomandimeve të Komitetit të Ministrave CM / Rec (2008) 4 mbi fuqizimin e integritit të fëmijëve të emigrantëve dhe të kaluarës së emigrantit dhe CM / Rec (2007) 9 mbi projektet e jetës për të miturit e pashoqëruar të emigrantëve.

38. Gjithashtu referoju Rekomandimit të Asamblesë Parlamentare 1703 (2005) mbi "Mbrojtjen dhe ndihmën për fëmijët e ndarë që kërkojnë azil".

39. Referoju Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës në Rekomandimin 253 (2008) mbi "Integrimin shoqëror të fëmijëve që jetojnë dhe / ose punojnë në rrugë".

40. Referoju "Rinia dhe përjashtimi në zonat e pafavorizuara urbane: adresimi i shkaqeve të dhunës" (Tendencat në kohezionin social, Nr 8, Këshilli i Evropës, 2004).

41. Referoju Rekomandimit të Asamblesë Parlamentare 1561 (2002) mbi "Masat sociale për fëmijët e luftës në Evropën Jug-Lindore" dhe Rezolutat e tij 1587 (2007) mbi "Situatën e fëmijëve që jetojnë në zonat pas konfliktit në Ballkan", 1215 (2000) mbi "Fushatën kundër rekrutimit në ushtri të fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre në konfliktet e armatosura", dhe 1212 (2000) mbi "Përdhunimin në konflikte të armatosura".

42. Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM / Rec (2008) 11, cituar më lart.



## Strategjia e integruar kundër dhunës





prindërore që respekton të drejtat e fëmijës dhe interesat më të mira të fëmijëve, ushqen, fuqizon, udhëzon dhe i njeh fëmijët si individë në të drejtën e tyre. Prindërimi pozitiv nuk është tolerant, por përcakton kufijtë të cilët u nevojiten fëmijëve për t'i ndihmuar në zhvillimin e potencialit të plotë të tyre <sup>43</sup>.

3. Kujdesi i institucionalizuar duhet të përdoret vetëm në interesin më të mirë të fëmijës, si një çështje të instancës së fundit, për periudhën më të shkurtër të mundshme të kohës, dhe që ka si objektiv kryesor integrimin e suksesshëm dhe/apo ri-integrimin e fëmijës në shoqëri <sup>44</sup>. Fëmijët mund të vendosen në institucione vetëm për të përmbushur nevojat që janë përcaktuar si të domosdoshme mbi bazën e një analize multidisiplinore.

### 5.3. Kuadri institucional

1. Kuadri i qëndrueshëm institucional që nevojitet për realizimin e strategjisë duhet të përbëhen nga elementet kryesore të mëposhtme :
  - a. një agjensi në nivel kombëtar (ku është e mundur dhe në përputhje me rregullat vendase) që ka si përgjegjësi kryesore mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna. Ky autoritet duhet të luajë një funksion kryesor koordinimi dhe monitorimi sa i përket implementimit të strategjisë dhe merr përgjegjësi të plotë në rastet e dhunës ndaj fëmijëve ;
  - b. çdo institucion publik që kontribuon në mbrojtjen e fëmijëve duhet të ketë një rol të përcaktuar qartë në përputhje me objektivat më të gjera të strategjisë. Mandatet e institucioneve duhet të kenë një detyrim të qartë për të bashkëpunuar me agjensinë e koordinimit dhe të gjitha institucionet dhe aktorët e tjerë, duke përfshirë shoqërinë civile. Mandatet e institucioneve të ndryshme dhe përshkrimet e punës së stafit të tyre duhet të jenë të lidhura reciprokisht ;



43. Referoju Rekomandimit Rec (2006) 19 të Komitetit të Ministrave për politikën në mbështetje të prindërimit pozitiv.

44. Referoju Nenit 9, KKBDF, projekt-udhëzimet e OKB-së për përdorimin e duhur dhe kushtet e kujdesit alternativ për fëmijët, dhe Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, Rec (2005) 5, të cituara më lart..






## Strategjia e integruar kundër dhunës



- c. duhet të themelohet një institucion i pavarur për të drejtat e njeriut në përputhje me parimet <sup>45</sup>, e Parisit për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijës (për shembull, një avokat populli / komisioner posaçërisht për të drejtat e fëmijëve, i ngritur me ligj, dhe të jetë qoftë i pavarur ose si një pikë qendrore brenda një institucioni ekzistues për të drejtat e njeriut). Këtij institucion duhet t'i jepen kompetenca të tilla që t'i mundësojnë kryerjen e mandatit të tij në mënyrë efektive dhe të pavarur, duke përfshirë kompetencën për të dëgjuar çdo person; për të marrë çdo informacion dhe/apo dokument të nevojshëm për vlerësimin e situatave që janë brenda kompetencave të tij; për të aksesuar në çdo kohë mjediset që ofrojnë kujdes për fëmijët; të propozojë iniciativa dhe masa, duke përfshirë masat legjislative, të zhvillojë fushata ndërgjegjësuese; të shpërndajë informacion, veçanërisht te fëmijët, mbi të drejtat e fëmijës; dhe të monitorojë veprimtarinë e qeverisë. Ky institucion duhet të pajiset me një infrastrukturë të përshtatshme, financim (duke përfshirë veçanërisht të drejtat e fëmijës, brenda institucioneve me bazë të gjërë), personel dhe ambiente. Ai duhet të asociohet me hartimin e strategjisë, vlerësimin dhe vijueshmërinë;
- d. një strukturë, si një observator për të drejtat e fëmijës, një zyrë kombëtare e statistikave ose një institut hulumtimi që ka të bëjë me fëmijët duhet të bashkërendojë mbledhjen, analizën, menaxhimin dhe shpërndarjen e të dhënave mbi dhunën dhe të promovojë punën kërkimore për të informuar për hartimin dhe implementimin e strategjisë;
- e. të gjitha institucionet e kujdesit dhe sigurimit të shërbimeve për fëmijët duhet të jenë të akredituara dhe të regjistruara pranë autoriteteve kompetente publike në bazë të legjislacionit përkatës dhe minimumit të standardeve kombëtare të kujdesit. Duhet të instalohet kontrolli i brendshëm dhe mekanizmat e pavarur të monitorimit për të siguruar përputhjen me standardet;
- f. gjitha institucionet, shërbimet dhe strukturat përgjegjëse për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të inkurajohen për miratimin e kodeve të sjelljes, duke përfshirë ndalimin, parandalimin dhe refuzimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, dhe që t'i përmbahen plotësisht këtyre kodeve. Modele të përshkrimeve të punës duhet të krijohen për çdo kategori profesionale. Ato duhet të përmbajnë çdo detyrim për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe të raportojnë dhunën te autoritetet kompetente;
- g. Duhet vendosur lidhje të nevojshme mes të institucioneve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, dhe duhet të ndërtohen partneritete efektive, duke u bazuar në ndarjen e qartë të kompetencave të caktuara në marrëveshjet përkatëse të partneritetit;
- h. shoqëria civile duhet të bëhet një pjesë përbërëse e kuadrit institucional, dhe aktorë të tjerë, si institucionet për të drejtat e njeriut, rrjetet profesionale, fëmijët dhe organizatat për fëmijët, duhet të ftohen për të kontribuar në hartimin, implementimin, vlerësimin dhe vijueshmërinë e strategjisë.

45. Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 48/134 të datës 20 dhjetor 1993.





## 6. Shërbimet dhe mekanizmat miqësorë në funksion të fëmijës

### 6.1. Parime të përgjithshme

1. Objektivi kryesor i institucioneve, shërbimeve dhe mjediseve përgjegjëse për kujdesin, arsimimin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të jetë sigurimi, në masën maksimale të mundshme, i mbijetesës, zhvillimit dhe mirëqenies <sup>46</sup> së fëmijëve.
2. Të gjithë fëmijët duhet të kenë akses në shërbime cilësore, të përshtatura sipas nevojave të tyre. Përdorimi i modeleve multidisiplinore të shërbimeve, duke përfshirë asistencën dhe orientimin familjar për mirëqenien shëndetësore, edukuese dhe psikologjike, duhet të promovohen gjerësisht. Modele të tilla duhet të mbështeten mbi bashkëpunimin e fortë ndërsektorial, stafin e kualifikuar, kurrikulën e integruar, dhe një kuadër të zbatimit të centralizuar.
2. Duhet të vihen në dispozicion, veçanërisht në nivel lokal, shërbimet për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e fëmijëve dhe trajtimin e viktimave. Duhet të aplikohen ndërmjet agjensive, përmes marrëveshjeve dhe protokolleve, procedura dhe mekanizma të besueshëm, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit përkatës dhe praktikës së mirë.

### 6.2. Standardet e kujdesit për fëmijën

1. Duhet të përgatiten rregullore për të gjitha institucionet, shërbimet dhe mjediset përgjegjëse për kujdesin, arsimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke vendosur standarde që kanë për qëllim interesin më të mirë dhe zhvillimin e plotë të fëmijës <sup>47</sup>. Respektimi këtyre standardeve duhet të sigurohet nëpërmjet trajnimit të personelit, kontrollit të brendshëm dhe monitorimit të rregullt të pavarur. Çdo shkelje e të drejtave të fëmijës në institucionet e tilla duhet të sanksionohet në përputhje me procedurat e përshtatshme dhe efektive.
2. Duhet të zbatohen kërkesa specifike për sistemin e drejtësisë për të miturit dhe mjediset që ofrojnë kujdes të institucionalizuar për të siguruar që të drejtat e fëmijës të jenë plotësisht të mbrojtura, që fëmijët të gëzojnë një cilësi të mirë të jetës dhe që të ketë mundësi që ata të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet që gëzojnë normalisht moshatarët <sup>48</sup> e tyre.
3. Duhet të aplikohet një sistem për të bërë një vlerësim të plotë të personave që punojnë në kontakt me fëmijët, në çdo cilësi, gjë që siguron një balancë të përshtatshme midis të drejtës së fëmijës për mbrojtje nga dhuna dhe të drejtës së individit për një emër të mirë.

46. Referoju Nenit 6, KKBDF.

47. Gjithashtu referoju nenit 3, KKBDF, Udhëzimet e OKB-së për përdorimin e duhur dhe kushtet për kujdesin alternativ, dhe Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, Rec (2002) 8, të cituara më sipër.

48. Gjithashtu referoju Rekomandimit Rec (2003) 20 të Komitetit të Ministrave në lidhje me mënyra të reja të trajtimit të kriminalitetit të të miturve dhe rolin e drejtësisë për të miturit, dhe Rec (2005) 5, të cituara më sipër.



## 6.3. Monitorimi i pavarur

1. Të gjitha institucionet, shërbimet dhe mjediset përgjegjëse për kujdesin, arsimin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të jenë subjekt i monitorimit të rregullt e të pavarur me qëllim që të:
  - a. sigurojë që masat mbrojtëse ligjore si për fëmijët, dhe për stafin të jenë respektuar plotësisht;
  - b. verifikojë përshtatshmërinë dhe korrektësinë e shpenzimeve publike;
  - c. japë udhëzime mbi zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për mirëqënien e fëmijës.
2. Monitorimi duhet të kryhet nga një organ i pavarur i përcaktuar me ligj dhe i pajisur me personel të trajnuar posaçërisht.

## 6.4. Raportimi i dhunës

1. Edukimi për të drejtat e fëmijës dhe njohuritë dhe mirëkuptimi i autoriteteve tek të cilët mund të raportohet dhuna janë dy kushtet thelbësore që mundësojnë raportimin më të gjerë të dhunës si nga fëmijët, ashtu edhe të rriturit. Për të qenë realisht të efektshëm, mekanizmi i raportimit duhet të jetë miqësor ndaj fëmijës dhe pjesë e një sistemi më të gjerë që përfshin raportimin, referimin dhe shërbimet ndihmëse. Një sistem i tillë duhet të respektojë të drejtat e fëmijës dhe t'i ofrojë fëmijëve (dhe, ku është e përshtatshme, vetë familjeve të tyre) mbrojtjen e nevojshme, duke përfshirë edhe mbrojtjen e privatësisë së tyre, pa vonesë të panevojshme.
2. Raportimi i dhunës duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, duke përfshirë ata të organizatave dhe subjekteve private që kryejnë funksione në emër të shtetit. Aty ku raportimi i detyrueshëm tashmë ekziston, duhet të shqyrtohet dhe të mbahet nën kontroll të rregullt shkalla në të cilën agjensi të ndryshme përmbushin detyrimet e tyre të raportimit.
3. Për të inkurajuar raportimin më të gjerë nga profesionistët, mund të prezantohen ndryshime legislative në mënyrë që të:
  - a. mbrohen ata që raportojnë ose që ngrenë ankesa kundrejt rrezikut në rastet e gabimeve të arsyeshëm në vlerësimin e rrezikut të dhunës;
  - b. heqin një kërkesë për marrjen e lejes së prindërve apo kujdestarëve për të depozituar një ankesë;
  - c. sigurojnë që normat e konfidencialitetit nuk e pengojnë raportimin aty ku ekziston pëlqimi i fëmijës, ose kur gjykohet të mos ketë kapacitetin për të kuptuar, dhe ku profesionistët besojnë se raportimi ose referimi është në interesin më të mirë të fëmijës.



## Strategjia e integruar kundër dhunës



4. Fëmijët dhe familjet e tyre duhet të kenë akses në informacion, duke përfshirë një format miqësor ndaj fëmijës, në atë që aktet dhe praktikrat përbëjnë dhunë, për shembull ngacmimi dhe krijimi i bandave në shkolla, dhe ndaj kujt dhe si mund të raportohen këto raste. Një fëmijë duhet të jetë në gjendje të paraqesë një raport pa pëlqimin e prindit apo kujdestarit të saj apo të tij.
5. Çdo shërbim, institucion apo strukturë përgjegjëse për kujdesin, arsimin dhe mbrojtjen e fëmijëve duhet të ketë një shërbim të mirë-publikuar dhe lehtësisht të aksesueshëm, të respektueshëm ndaj privatësisë së fëmijës dhe t'i kërkohej që të hetohen pretendimet e dhunës menjëherë dhe plotësisht. Të gjithë fëmijët, përfshirë ata që janë në kujdestari në një institucion të ligjit, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara,<sup>49</sup> prindërit dhe kujdestarët e tyre duhet të informohen mbi mekanizmat e ankesave të tilla. Procedura duhet të lejojë për akses të efektshëm për të mbështetur shërbimet duke shmangur çdo stigmatizim të fëmijës viktimë.
6. Një linjë telefonike falas, e pavarur, konfidenciale, e mirë reklamuar, e lehtë për tu mbajtu mend, duhet të vihet në dispozicion për fëmijët për të kërkuar këshillim konfidencial dhe profesional dhe për të raportuar dhunën.
7. Shërbimet e ndihmës së shpejtë duhet të ngrihen në çdo lokalitet për fëmijët viktimë të dhunës, duke përfshirë viktimat e shfrytëzimit seksual, abuzimit seksual, praktikrat tradicionale të dëmshme dhe të gjitha format e dhunës në shtëpi dhe familje. Detajet e kontaktit të shërbimeve duhet të bëhen të njohura për fëmijët, familjet dhe të tjerët që janë në kontakt me fëmijët.

### 6.5. Mekanizmat referues

1. Procedurat për referimin e fëmijës viktimë të dhunës dhe modalitetet për bashkëpunimin ndërmjet agjensive duhet të përcaktohen qartë (që do të thotë, ndërmjet shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë, policisë, autoriteteve të akuzës, agjensive vullnetare dhe private). Procedurat e tilla duhet të miratohen pas një vlerësimi të rrethanave specifike të çdo viktime të veçantë, duke i dhënë rëndësi përkatëse pikëpamjeve të saj apo tij dhe, kur është në interesin më të mirë të fëmijës, edhe të pikëpamjeve të prindërve apo kujdestarëve të saj apo tij.
2. Fëmijët duhet të inkurajohen, duke përfshirë ofrimin e avokaturës së pavarur dhe shërbimeve mbështetëse, për të folur me autoritetet përkatëse në lidhje me përvojën e tyre të dhunës.
3. Fëmija viktimë duhet të vlerësohet pa vonesë, dhe për viktimat e dhunës brenda shtëpisë dhe familjes, duhet të krijohet kapaciteti mbrojtës për një kujdestari pa dhunë edhe në shtëpi për fëmijët e tjerë që jetojnë aty.

49. Jo vetëm fëmijët me aftësi fizike të kufizuara si ata me dëmtim të pamjes, por edhe fëmijët me aftësi të kufizuara intelektuale. Për informacion në lidhje me formatin "për tu lexuar me lehtësi" i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara mendore, shih <http://www.osmhi.org/?page=139>



## 6.6. Shërimi, rehabilitimi dhe ri-integrimi shoqëror

1. Shteti duhet të marrë të gjitha masat e duhura për të nxitur shërimin fizik dhe psikologjik dhe rehabilitimin e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të dhunës<sup>50</sup> dhe familjeve të tyre, nëse është e nevojshme. Shërbime të tilla duhet të sigurohen pa vonesë dhe në një mjedis, i cili nxit shëndetin e fëmijës, vetë-respektin dhe dinjitetin.
2. Zbatimi i masave për shërimin dhe ri-integrimin e fëmijës autor të dhunës duhet të bazohet në interesat më të mira të fëmijës, i kufizuar nga graviteti i veprës penale të kryer (parimi i proporcionalitetit) dhe duke marrë parasysh moshën, gjendjen fizike dhe mendore, zhvillimin, aftësitë dhe rrethanat personale (parimi i individualizimit), sikurse konstatohen kur është e nevojshme nga raportet<sup>51</sup> hetimore psikologjike, psikiatrike apo sociale.
3. Shërbimet përgjegjëse për shërimin, rehabilitimin dhe ri-integrimin social të fëmijës viktimë, dëshmitar apo autor të dhunës duhet të ndjekin një qasje multidisiplinore dhe me shumë agjensi, duke e parë fëmijën në një kontekst më të gjerë të familjes, komunitetit dhe sfondit kulturor të saj apo tij. Një ekuilibër i duhur duhet të kërkohet ndërmjet shërbimeve të përgjithshme dhe të specializuara, si edhe programeve që trajtojnë faktorët individualë dhe marrëdhëniet përkatëse, si dhe ato që fokusohen në aspektet komunitarë dhe shoqërore.

## 6.7. Sistemi i drejtësisë<sup>52</sup>

1. Duhet të ndiqen procedurat gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore në interesin më të mirë dhe në respektimin e plotë të të drejtave të fëmijës, duke përfshirë të drejtën për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës.
2. Për të mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe interesat e ligjshme të fëmijëve gjatë gjithë procesit, atyre duhet t'u jepet akses në ndërmjetësim, shërbime ligjore të lira dhe të pavarura, dhe shërbime avokatie dhe mbështetëse. Duhet të bëhen përpjekje për të siguruar që mjetet juridike në dispozicion të jenë efektive dhe të ketë zbatim efektiv të vendimeve gjyqësore dhe gjykimeve.
3. Procedurat gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore që përfshijnë fëmijët duhet të përshpejtohen, të trajtohen si prioritet dhe të përfundojnë pa vonesë të pajustificueshme. Për këtë qëllim, duhet të inkurajohet bashkëpunimi dhe koordinimi më i ngushtë midis të gjitha palëve në procesin gjyqësor.

50. Referoju Nenet 39, KKBDP dhe Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, Rec (2003) 20, cituar më lart.

51. Referoju Rekomandimit të Komitetit të Ministrave CM / Rec (2008) 11, cituar më lart.

52. Në vitin 2009 Grupi i Specialistëve për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijës (CJ-S-CH) hartoi Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijës. Udhëzimet do të miratohen si një rekomandim i Komitetit të Ministrave në vitin 2010.



## Strategjia e integruar kundër dhunës



4. Procedurat gjyqësore dhe jashtë-gjyqësore duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për t'i kushtuar vëmendjen e duhur pikëpamjeve të saj apo tij. Për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë, fëmijët duhet të informohen rreth të drejtave të tyre procedurale në mënyrë të tillë që të merret parasysh mosha dhe niveli i tyre i pjekurisë dhe të mbështeten nga një përfaqësues i pavarur.
5. Duhet të ofrohen mbrojtje, procedura dhe lehtësira të veçanta për të siguruar që fëmija viktimë dhe dëshmitare e dhunës të jetë plotësisht i mbështetur. Në veçanti:
  - a. procedurat gjyqësore nuk duhet të rëndojnë traumat e përjetuara nga fëmija. Aty ku është e përshtatshme, përgjigja e drejtësisë duhet të pasohet me shpejtësi nga shërbimet e mbështetjes adekuate;
  - b. duhet të mbrohet privatësia e fëmijëve dhe e familjeve të tyre gjatë të gjithë procesit<sup>53</sup>. Aty ku është e nevojshme, duhet të merren masat e duhura të sigurisë për të shmangur intimidimin, nënshtrimin nga shpagimi apo përsëritjen e viktimizimit të fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të dhunës dhe të familjeve të tyre.
6. Duhet të përcaktohet me ligj dhe të vendoset në mënyrë të përshtatshme mosha e përgjegjësisë penale, duke pasur parasysh faktorët që lidhen me zhvillimin e fëmijës. Për fëmijët që janë autorë të dhunës konceptet e ndëshkimit dhe të shtypjes duhet t'i hapin rrugë rehabilitimit të objektivave të drejtësisë rregullatore, duke i kushtuar vëmendjen e duhur efektivitetit të sigurisë publike dhe garancive të duhura të të drejtave të njeriut dhe ligjore për fëmijët viktimë<sup>54</sup>.
7. Duhet të krijohen alternativat për kujdesin e institucionalizuar për fëmijët autorë të dhunës, të tilla si ndihma, udhëzime dhe urdhra të mbikqyrura; këshillim; lirim me kusht; kujdestari; dhe programe edukimi dhe trajnimi profesional. Objektivi i përgjithshëm i masave të tilla duhet të jetë për të lehtësuar shoqërimin e suksesshëm të fëmijëve dhe ri-integrimin në familje, komunitet dhe shoqëri.
8. Fëmijët autorë të dhunës nuk duhet të privohen nga liria e tyre përveç rasteve kur është e nevojshme si masë e fundit, që përdoret për një periudhë të shkurtër kohore dhe që zhvillohet në mjedise të projektuara posaçërisht për ta. Kushtet e dënimit duhet të jenë në përputhje me KKBDF-në dhe standardet e tjera përkatëse dhe të marrin në konsideratë nevojat<sup>55</sup>. specifike të fëmijës. Fëmijët që kryejnë çfarëdolloj dënimi duhet ta ndahen veçmas nga të dënuarit e rritur, përveç rasteve kur kjo konsiderohet në kundërshtim me interesin<sup>56</sup> më të mirë të tyre.

53. Referoju Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në rastin V. vs. Mbretërisë së Bashkuar, 1999.

54. RReferoju Rekomandimit të Komitetit të Ministrave, CM/ Rec (2008) 11, cituar më lart.

55. Referoju Rekomandimeve të Komitetit të Ministrave Rec (2006) 2 dhe CM / Rec (2008) 11, të dyja të cituara më sipër.

56. Op.cit. i referohet gjithashtu Rregullave të OKB-së për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria e tyre (Rregullat e Havanës), Rregullave Minimale të OKB-së për masat e Mos-ruajtjes (Rregullat e Tokyos) dhe Rregullat e Standardeve Minimale të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit).




## 7. Hulumtime dhe mbledhje të dhënash

1. Identifikimi i një strategjie efektive për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna varet nga disponueshmëria dhe analiza e duhur e të dhënave në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Miratimi i një axhende kombëtare të kërkimit paraqet mënyrën më të përshtatshme për të promovuar një qasje të integruar dhe sistematike për mbledhjen e të dhënave, analizimin, shpërndarjen dhe hulumtimin e tyre. Kjo qasje, ndër të tjera, nënkupton në vijim:

### *Hulumtim*

- a. studime bazë mbi dhunën ndaj fëmijëve si një parakusht për çdo proces të planifikimit strategjik;
- b. hulumtime etike dhe të rregullta që përfshijnë intervista me fëmijë dhe veç e veç me prindërit, ose kujdestarët e tyre, në kushtet e konfidencialitetit dhe besimit, për të rikrijuar sa të saktë të jetë e mundur përvojën aktuale të dhunës së përjetuar nga fëmijët;
- c. hulumtime në shkallë të gjerë të shkaqeve të dhunës dhe të ndërvarësisë ndaj formave të saj;
- d. zhvillimi i një metodologjie të harmonizuar me një sërë treguesish të përbashkët, për të lejuar identifikimin e grupeve të fëmijëve vulnerabël ndaj dhunës;
- e. hulumtime të vazhdueshme mbi natyrën e saktë të rreziqeve me të cilat hasen fëmijët në lidhje me internetin, dhe mbi mënyrën se si zhvendosen këto rreziqe me kalimin e kohës dhe si zbuten ato nga ndërhyrjet;
- f. kërkime në faktorët mbrojtës, sidomos në mekanizmat e elasticitetit të fëmijëve;
- g. sondazhet me të rritur dhe fëmijë autorë të dhunës për të zhvilluar kritere dhe parametra për vlerësimin dhe trajtimin e tyre;
- h. kërkime mbi metodat që funksionojnë për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe për të vlerësuar përgjigjet ekzistuese, duke përfshirë metodologjitë për vlerësimin dhe gjykimin ndaj shërbimeve të parandalimit të dhunës si dhe të programeve dhe zhvillimit të kritereve të cilësisë;
- i. sondazhet për të përcaktuar kostot sociale të dhunës kundër fëmijëve.





## Strategjia e integruar kundër dhunës



### Monitorim statistikor

